



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 838/ 8Prot.

Tiranë, më 11.09.2025

V E N D I M

Nr. 211, Datë 11. 09. 2025

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar,² mori në shqyrtim ankesën nr. 128, datë 28.05.2025, paraqitur nga Fondacioni “Së Bashku” (në vijim *pala ankuese*) kundër Drejtorisë Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Tiranë, me pretendimin për diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, pala ankuese parashtron se: *Në kuadër të punës sonë si Fondacion, nga takimet e zhvilluara me personat me aftësi të kufizuara dhe nga vëzhgimet tona gjatë marrjes së shërbimeve të ndryshme pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Tiranë, konstatuam problematika me aksesueshmërinë në këtë institucion.*

Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Tiranë ka këto problematika:

- *Nuk ka parkime të rezervuara për personat me aftësi të kufizuara.*
- *Zona e shërbimeve ka një rampë, por mënyra se si është ndërtuar është jofunksionale dhe e padobishme dhe nuk të çon askund.*
- *Trotualet nuk janë të aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuara.*

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

- *Nuk ka elementë të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara në shikim.*
- *Në zonat e zyrave ka shkallë dhe nuk ka rampë, dhe trotualet janë përsëri të larta.*

Përfundimisht, pala ankuese kërkon nga Komisioneri:

1. Konstatimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara që përfitojnë shërbime në Drejtorinë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Tiranë.
2. Përmirësimin e situatës së aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara në këtë institucion, si dhe zbatimin e të gjitha standardeve teknike dhe ligjore të aksesueshmërisë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat e paraqitura nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm, për çështje që lidhen me interesa kolektive.

Bazuar në dispozitën e mësipërme ligjore rezulton se, kërkesën për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit mund ta bëjë edhe një palë e cila nuk pretendon diskriminim në emrin e vet, pra që nuk ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë të vetin. Në këtë rast që kjo palë të legjitimohet për të bërë ankesë dhe për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit, duhet të provojë se është mbajtëse e interesave kolektive, të cilat mund të cenohen nga procedura konkrete administrative. Një palë e tillë duhet të provojë lidhjen e detyrueshme, të drejtpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë që ajo kryen dhe çështjes së paraqitur pranë Komisionerit.

Bazuar në nenin 3, pika 11, të ligjit nr.10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Organizatat me interesa legjitime” janë ato organizata, të cilat janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe kanë si objekt të deklaruar të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ose u ofrojnë ndihmë viktimave të diskriminimit”*.

Nga aktet e administruara rezulton se, Fondacioni “Së bashku” është një organizatë jofitimprurëse, regjistruar si person juridik, me Vendimin nr. 427, datë 18.06.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Bazuar në ankesën e paraqitur Fondacioni “Së Bashku” nuk pretendon se është cenuar në interesin e tij të ligjshëm dhe të drejtpërdrejtë, por pretendon diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara që përfitojnë shërbimet në Drejtorinë Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Tiranë.

Bazuar në statutin dhe aktin e themelimit, Fondacioni “Së Bashku”, është një organizatë jofitimprurëse e krijuar, me qëllimin që t’ju përgjigjet nevojave të grupeve të përjashtuara në Shqipëri, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se provohet lidhja e detyrueshme, e drejtpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë së ankuesit dhe çështjes që kjo organizatë ka paraqitur, duke

vlerësuar përfundimisht se ankuesi legjitimohet para Komisionerit për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi.

Bazuar në nenin 7 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 128 Regj., datë 28.05.2025, që i përket ankuesit Fondacioni “Së Bashku” kundër Drejtorisë Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Tiranë, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr. 838/1 prot., datë 02.06.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Tiranë si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, si mëposht vijon:
 - Kopje të dokumentacionit ligjor dhe teknik mbi përmbushjen e standardeve dhe kriterëve sipas parashikimeve ligjore në fuqi, që lidhen me aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, në hyrje dhe ambjentet e brendshme në Drejtorin Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Tiranë .
 - A është pajisur ambjenti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Tiranë, me teksturë/reliev jashtë dhe brenda për të udhëhequr personat me aftësi të kufizuar në shikim? Informacioni duhet të shoqërohet me kopje të dokumentacionit përkatës provues.
 - A është pajisur ky ambjent me informacion akustikë? Informacioni duhet të shoqërohet me kopje të dokumentacionit përkatës provues.
 - Kur është realizuar rikonstruksioni apo përshtatja e ambjenteve të Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Tiranë dhe a janë adresuar aspektet që lidhen me aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara? Informacioni duhet të shoqërohet me kopje të dokumentacionit përkatës provues.
 - Çfarë investimesh janë kryer në ambjentet e këtij institucioni dhe a kanë prekur këto investimet aspekte që kanë të bëjnë me aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuar? Informacioni duhet të shoqërohet me kopje të dokumentacionit përkatës provues.
 - Çfarë masash janë marrë nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Tiranë për evidentimin e pengesave/barrierave në aksesueshmëri për personat me aftësi të kufizuar? A është bërë nga ana juaj planifikim i fondeve të nevojshme dhe afateve kohore për

garantimin e aksesueshmërisë në aksesueshmëri për personat me aftësi të kufizuar, sipas legjislacionit në fuqi? Informacioni duhet të shoqërohet me kopje të dokumentacionit përkatës provues.

- Çdo informacion tjetër që ju do e gjykoni të arsyeshëm se do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështje.

2. Me shkresën nr.11471/1 prot., datë 17.05.2025³, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, dërgoi një informacion në lidhje me këtë çështje, në të cilën informon Komisionerin si më poshtë vijon:

“Në përgjigje të shkresës suaj nr. 838/1 prot., datë 02.06.2025, protokolluar me tonën me nr. 11471 prot., datë 02.06.2025, “Njoftim dhe kërkesë për informacion”, lidhur me ankesën e Fondacionit “Së Bashku”, me pretendimin për diskriminim për personat me aftësi të kufizuar, pasi kanë konstatuar problematika të aksesueshmërisë në DRSHTRR Tiranë, ju sqarojmë se:

DPSHTRR është e ndërgjegjshme për rëndësinë e aksesueshmërisë dhe, në kuadër të investimeve të ardhshme, do të marrë masa konkrete për përmirësimin e infrastrukturës, duke vendosur sinjalistikë vertikale dhe horizontale sa më pranë hyrjes së ambienteve ku do të marrin shërbim. Lidhur me pretendimin se “zona e shërbimeve ka një rampë, por mënyra si është ndërtuar është jofunksionale, e padobishme dhe nuk të çon askund”, nuk qëndron, pasi pozicionimi i rampës është i aksesueshëm dhe funksional, i cili mundëson mbërritjen pranë sallës së Drejtorisë së Regjistrimit të Mjeteve dhe Drejtorisë së Drejtimit të Mjeteve, kjo e vërtetuar edhe me pamjet në fotot bashkëlidhur kësaj shkrese.

Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Tiranë aktualisht nuk ka sinjalistikë të dedikuar, si dhe nuk disponon vende parkimi për personat me aftësi të kufizuar, por theksojmë se këta individë kanë përparësi në marrjen e shërbimeve pranë ambienteve tona, parkojnë në afërsi të ambienteve, duke iu ofruar shërbim jashtë radhe, si dhe duke u shoqëruar nga staf i jonë.

Aktualisht, në ambientet e DRSHTRR Tiranë nuk disponojmë sisteme apo informacione me karakteristika akustike për personat me aftësi të kufizuar; megjithatë, jemi në proces rishikimi të situatës dhe përgatitjes së një plani të detajuar veprimi, duke vlerësuar shqetësimin tuaj për përmirësimin e aksesueshmërisë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet teknike përkatëse.

Për sa më sipër, DPSHTRR, në investimet e ardhshme, do të marrë masa për të parashikuar ndërhyrjet e nevojshme për të garantuar kushte sa më të përshtatshme dhe të aksesueshme për të gjithë qytetarët, në përputhje me kuadrin ligjor dhe standardet teknike në fuqi.

³ Administruar pranë Komisionerit me nr.836/3 prot, datë 19.06.2025.

3. Me shkresën nr.27756/1 prot., date 18.06.2025⁴, Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Tiranë, informon Komisionerin si më poshtë vijon: *“Në përgjigje të shkresës tuaj Nr. 838/1 prot., datë 02.06.2025, protokolluar me tonën me Nr. 27756 prot., datë 03.06.2025, "Njoftim për kërkesë dhe informacion", ju informojmë se përgjigja është kthyer nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor me shkresën Nr. 11471/1 prot., datë 17.06.2025, pasi Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Tiranë funksionon si institucion në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.”*
4. Me shkresën nr.838/4 prot., datë 24.06.2025 të Komisionerit i është përcjellë palës ankuese, shkresat nr.11471/1 prot., datë 17.05.2025 të Drejtorisë e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe nr.27756/1 prot., date 18.06.2025 të Drejtorisë Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Tiranë për të bërë parashtrimet në lidhje me këto përgjigje.
5. Me email-in e datës 23.06.2025, pala ankuese i ka kthyer përgjigje Komisionerit, ku informon se: *“E lexova me kujdes përgjigjen dhe qëndrimi im nuk ka ndryshuar për pretendimet e mia. Në foto, ata tregojnë rampën e vetme në trotuar, por ka një rampë tjetër/rampë të dytë që të çon brenda ndërtesës, e cila, siç thashë, është e padobishme dhe e pozicionuar në një mënyrë që nuk i shërben qëllimit të saj. Ata nuk e kanë mohuar pjesën tjetër të pretendimeve të mia.”*
6. Në mbështetje të neneve 78-86 të Kodit të Procedurave Administrative, nenit 32, pika 1, shkronja c), dhe pikat 2, 3 e 4 të këtij neni, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, nenit 39, të Rregullores së Brendshme *“Për organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”⁵*, si dhe në zbatim të Urdhrit nr. 98, datë 18.08.2025, të Komisionerit, në datën 28.08.2025, nga inspektorët e KMD-së, u realizua inspektimi në ambientet e Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Tiranë.

Objekti i inspektimit ishte marrja e informacionit të nevojshëm dhe dokumentacionit respektiv, në kuadër të shqyrtimit administrativ të kësaj çështjeje.

Gjatë takimit me përfaqësuesit⁶ e Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Tiranë, u mbajt procesverbali përkatës, në të cilin u evidentua se:

Nga verifikimi në terren, u konstatua se, pas paraqitjes së ankesës nga subjekti ankues dhe njoftimit të marrë nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë ka ndërmarrë masa konkrete në funksion të përmirësimit të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara.

⁴ Administruar pranë Komisionerit me nr.838/4 prot, datë 19.06.2025.

⁵ <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2021/05/RREGULLORE-KMD.pdf>

⁶ Z. A. T, me detyrë Drejtor i DRRSHT, z. I. S, me detyrë Kryetar i Degës së Shërbimeve Mbështetëse.

Më konkretisht, janë vendosur vende parkimi të personalizuar për personat me aftësi të kufizuara, të pajisura me sinjalistikën përkatëse, në përputhje me ngjyrat standarde dhe tabelat treguese të përcaktuara në Kodin Rrugor dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Parkimi është vendosur në afërsi të hyrjes kryesore të institucionit, për të siguruar akses sa më të lehtë, dhe është shoqëruar me rampë të shënuar me ngjyrat përkatëse dhe sinjalistikë kufizuese, që mundëson lëvizjen e lirë të karrocave."

Në hyrje është evidentuar një pengesë me lartësi rreth 5 cm, për të cilën drejtuesi i institucionit është shprehur se janë porositur dy rampa portative të lëvizshme, të cilat do të vendosen në të dy sallat ku ofrohen shërbime për publikun.

Gjithashtu, në ambientet e brendshme të institucionit janë marrë masa organizative për t'i siguruar këtyre individëve përparësi në ofrimin e shërbimit, përmes caktimit të personelit ndihmës, i cili kujdeset që personat me aftësi të kufizuara të mos qëndrojnë në radhë dhe të shoqërohen drejt një sporteli të dedikuar dhe të përshtatur për ta.

Sipas verifikimit, standardi i tavolinave të sporteleve është 75 cm në lartësi. Staf i përgjegjës ka sqaruar se janë marrë të gjitha masat për t'u ofruar këtyre individëve një shërbim pa pengesa fizike dhe të përshtatshëm për nevojat e tyre.

Nga ana e titullarit të institucionit janë marrë gjithashtu masa për formalizimin e këtyre shërbimeve përmes nxjerrjes së një njoftimi zyrtar, i cili është afishuar në ambientet e institucionit dhe përmban rregullat e aksesit dhe shërbimit për personat me aftësi të kufizuara, gratë shtatzëna dhe grupet e tjera vulnerabël me vështirësi në lëvizje.

Salla ku zhvillohet procesi i provimit për pajisjen me leje drejtimi ndodhet në një kat që arrihet vetëm përmes shkallëve, dhe aktualisht nuk ka të vendosur një pajisje ndihmëse për akses. Lidhur me këtë çështje, drejtuesi i institucionit ka bërë të ditur se ka informuar Drejtorinë e Përgjithshme për këtë pengesë dhe ka kërkuar zgjidhje përmes instalimit të një anshesori (ashensori ose rampë fikse). Komunikimi zyrtar mbi këtë kërkesë është në dispozicion dhe do t'i vihet në dijeni Komisionerit, si autoriteti që ka adresuar këtë shqetësim.

Drejtesia e institucionit ka theksuar se, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi, Drejtoria Rajonale nuk ka kompetencë të drejtpërdrejtë buxhetore për të financuar ndërhyrje infrastrukturore të tilla, pasi kjo është përgjegjësi e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor. Kjo e fundit është autoriteti përgjegjës për projektimin, financimin dhe realizimin e infrastrukturës së nevojshme për garantimin e aksesueshmërisë dhe trajtimin e çështjeve të kësaj natyre.

Drejtorja Rajonale ka konfirmuar se shqetësimet lidhur me aksesueshmërinë, por edhe problematika të tjera që lidhen me ofrimin e shërbimeve për grupet në nevojë, i ka përcjellë në vijimësi Drejtorisë së Përgjithshme për shqyrtim dhe veprim të mëtejshëm në përputhje me kompetencat dhe burimet përkatëse."

Me emailin e datës 01.09.2025, nga ana e inspektorit të çështjes, i janë përcjellë palës ankuese të gjitha konstatimet e bëra gjatë procesit të inspektimit pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Tiranë (DRSHTRR Tiranë), të ilustruara me dokumentacionin fotografik përkatës.

Më pas, me emailin e datës 08.07.2024, pala ankuese ka dërguar pranë institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, qëndrimin e saj përfundimtar, në të cilin shprehet si më poshtë: *“Faleminderit për emailin tuaj. Masat konkrete të ndërmarra nga institucioni në fjalë janë inkurajuese dhe për këtë arsye, ne e konsiderojmë qëllimin e kësaj ankese të arritur. Me respekt.”*

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”*, KMD vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* parashikohet përfundimi i procedurës administrative: *“Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”*.

Njëkohësisht, në referencë të nenit 94/1, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, i cili parashikon se: *“Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”*, Komisioneri deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, nenin 1, nenin 7, pika 1, neni 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, shkronja a) e nenin 33, pikat 9-10, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 128, datë 28.05.2025, paraqitur nga Fondacioni “Së Bashku”, kundër Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Tiranë, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA